



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Skupština Opštine štrpce
Kuvendi i Komunes se Shtërpcës
Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, 17, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpcës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, si dhe dispozitave të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datën 24.09.2010 miratoi këtë :

V E N D I M

MBI PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

I

Miratohet vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba komunale 01 – Nr-713 të datës: 01.06.2010 dhe atë siç vijon:

1. Neni 7 pika (a), numri rendor 39, 40, 41, 42, 43, 44 dhe 45 ,taksat për Zonën Turistike ndryshohen si në tabelën e poshtëshënuar.

Nr.R	Lloji i objektit	Njësia	Shuma në (€)
39.	Objektet nga druri - kati	m ³	7,5
40.	Objektet nga druri – nën kulmi	m ³	5.00
41.	Material i fort - bodrumi	m ³	3.00
42.	Material i fort - kati	m ³	6.00
43.	Objekte nga materiali i fort – nën kulmi	m ³	3.00
44.	Objektet ndihmëse (furrat, garazhet, pishinat, vilat, muret mbrojtëse dhe rrethojat...)	m ³ / m ²	2.00
45.	Objektet afariste	m ³	15,00

2. Neni 7 pika (a), plotësohet kështu që shtohen Taksa për Shfrytëzimin e Tregut sipas radhitjes së numrave rendorë me tekst dhe tabelë siç vijon:

Taksa për shfrytëzimin e tregut

Nr.R.	Emertimi	Shuma €	
		Ditore	Mujore
54	Pagesa për një tezgë	2,50	8.5
55	Dy e më shumë tezga	2,00	7
56	Kombit dhe traktorët të cilat ofrojnë shërbime para tregut	3,00	10
57	Kamionët të cilët ofrojnë shërbime në parkingun para tregut	5,00	17
58	Vendosja e imponuar e tezgave jashtë hapësirës së tregut	2,50	8.5

Vërejtje:

Shfrytëzuesit të cilët janë të vendosur në hapësirën e tregut me tezga të improvizuara do të paguajnë njëjtë sikurse tezgat e tregut (varësisht nga hapësira të cilën e shfrytëzojnë).

II

Obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtërpçës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për implementimin e këtij vendimi.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e **Kuvendit Komunal**

KUVENDI I KOMUNËS - SHTËRPCË

01-Nr- 1327

Më datë 03.11.2010

